

Nr. 2329/1
03.08.2026



Sek. Këshillit
03.08.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 600 prot.

Gjirokastrë, më 03.8.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË
Tepelenë

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 52, datë 20.7.2026, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 77, datë 22.12.2025, të Këshillit të Bashkisë Tepelenë ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2026’, i ndryshuar”, konfirmohet.

2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 53, datë 20.7.2026, “Për miratim të kërkesës për heqje dorë nga pasuria e paluajtshme me status juridik ‘Në përdorim të Bashkisë Tepelenë’, me numër pasurie 66/2, 291, 318 dhe 338, ZK 2404 dhe numër rendor të pronës në listën e inventarit 485 sipas VKM nr. 386, datë 25.5.2011, ‘Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kurvelesh, të qarkut të Gjirokastrës’, fusha e përdorimit: Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)”, është akt me karakter individual.

Në bazë të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’, akt normativ nënligjor është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Gjithashtu, neni 4, pika 1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, përcakton se aktet me karakter normativ janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”. Ky vendim nuk ka karakteristikat e një akti normativ, pasi nuk ka përmbajtje abstrakte në funksion të vendosjes së një rregullimi të përgjithshëm.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

3. Vendimii i këshillit të bashkisë nr. 54, datë 20.7.2026, "Për miratimin e modelit tip të strukturave të çmontueshme për njësitë tregtare ambulante në zonën turistike përgjatë aksit rrugor Tepelenë-Uji i Ftohtë-Hormovë", nuk konfirmohet.

Vendimi i këshillit bashkiak bie në kundërshtim me kreun V dhe VI, të VKM nr. 224, datë 1.4.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike". Ndonëse vendimi e cilëson modelin tip si strukturë të çmontueshme dhe jo të përhershme, dokumentacioni dhe specifikimet teknike të modelit të miratuar, bashkëngjitur vendimit të këshillit bashkiak, tregon një strukturë me kolona metalike të fiksuara dhe të mbështetura mbi bazament betoni, pra një strukturë jo e çmontueshme, jo e lëvizshme, në kundërshtim me përkufizimin e nenit 50, pika 1, të VKM-së së mësipërme ku përcakton se struktura duhet të jetë e lëvizshme, e çmontueshme dhe e vetëqëndrueshme. Gjithashtu, modeli tip ka përmasa dhe masë të shfrytëzimit të hapësirës publike që tejkalon ndjeshëm kufijtë që janë vendosur në nenin 50, pika 2 dhe 51, pika 2 të VKM 224/2026, për vendosjen e strukturave të përkohshme dhe të lëvizshme në hapësirat publike.

Gjithashtu, për shitjet ambulante të zbatohen detyrimet e parashikuara në Kreun V të VKM 224/2026.

4. Vendimii i këshillit të bashkisë nr. 55, datë 20.7.2026, "Për miratimin e masave administrative dhe nivelit të gjobave të aplikueshme në territorin e Bashkisë Tepelenë", nuk konfirmohet.

a) Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 11, pika 1, përcakton se: "1. Shërbimet e policisë rrugore janë: a) parandalimi, konstatimi dhe verifikimi i shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor; b) konstatimi dhe verifikimi i aksidenteve rrugore; c) kryerja e shërbimeve të drejtpërdrejta për rregullimin e trafikut; d) shoqërimi i mjeteve për sigurimin e qarkullimit; e) kujdesi dhe kontrolli i përdorimit të rrugës. ë) mbledhja, përpunimi, ruajtja, shpërndarja dhe përdorimi i të dhënave të aksidenteve rrugore në sistemin e të dhënave të aksidenteve rrugore. Modalitetet e këtij sistemi përcaktohen në aktet në zbatim".

Neni 12, pika 1, gërma 'c', i Kodit Rrugor përcakton se: "Kryerja e shërbimeve të policisë rrugore të përcaktuara nga ky Kod i takon: "Policisë së bashkisë, në bashkitë me popullsi më të madhe se 20 000 banorë, për territorin në juridiksion, vetëm për shkeljet që kanë të bëjnë me parkimet, të kryera në rrugët që janë në administrim/pronë të bashkisë, të parashikuara në nenin 7, me përjashtim të pikës 12 të tij, nenin 11 pika 1 shkronjat "a" dhe "e", nenin 85, 86, 87, 89, 155 pika 6, 156 pika 1 shkronjat "g" dhe "h", pika 2 shkronjat "d", "e", "g", "h", "i", "j", "k" dhe "l".

Duke qenë se Bashkia Tepelenë ka një popullsi nën 20 000 banorë, Policia Bashkiake Tepelenë nuk ka kompetencë konstatimin dhe dënimin e sjelljeve të rregulluara nga Kodi Rrugor dhe të përcaktuara si kundërvajtje në vendimin e këshillit bashkiak, të parashikuara në nenin 8.B, pikat 1, 4, 9, 10, 12, 13, 14 dhe 15, nenin 11, pika 1, nenin 12, gërma 'a'.

b) Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar, neni 8/1 dhe 25, pika 1, gërma 'b', përcakton se Policia e Shtetit është përgjegjëse për matjen e nivelit të zhurmës dhe marrjen e masave për ruajtjen e qetësisë publike nga veprimtaritë që lëshojnë zhurmë nga muzika mbi nivelet e lejuara kufi, pra, nuk është kompetencë e bashkisë sanksionimi dhe rregullimi i muzikës në bar-kafe, apo restorante, siç parashikohet në nenin 9, pika 2, e vendimit të këshillit bashkiak. Gjithashtu, masa e gjobës për kundërvajtjet administrative në fushën e zhurmës, që janë objekt i ligjit nr. 9774/2007, janë të sanksionuara në nenin 32, të ligjit të mësipërm dhe nuk mund të ndryshohen.

c) VKM nr. 224, datë 14.2.2026, "Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike", përcakton se në rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje të kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, ndaj subjektit do të merren masa administrative, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative". Për sa më sipër është e nevojshme, një harmonizim i sanksioneve dhe masës së gjobës që parashikon vendimi i këshillit bashkiak në lidhje me shfrytëzimin e hapësirave publik me ato të akteve ligjore të mësipërme.

ç) Neni 15 i tekstit bashkëlidhur vendimit, përcakton për pikën 1, të nenit 11, dy masa të ndryshme gjobe, 5000 dhe 20000 lekë, nën dy tituj të ndryshëm duke e bërë të vështirë për t'u zbatuar nga organi përkatës, duke krijuar hapësirë për trajtim arbitrar dhe të pabarabartë për raste të njëjta.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNPREFEKTI**

Avni Lala



Adresa: Sheshi "ÇerçizTopulli", Përmet, Shqipëri, Tel ++35584263435 Fax ++355263434 Email Prefekti.Përmet@mb.gov.al